Kuqezinjte vijojne pergatitjet para Andores

nga AlbaniaSoccer
E diel, 30 Maj 2010 15:15

Ekipi kombetar ka zhvilluar sot seancen e rradhes stervitore.Ne oren 11:00 kuqezinjte nen drejtimin e trajnerit Josip Kuzhe kane vijuar pergatitjet per takimin e rradhes miqesor qe do te lujne te merkuren kunder Andores. Ne Kavaje aty ku kuqezinjte po sterviten Kuzhe ka zgjedhur te zhvilloje nje seance te lehte e cila nuk ka zgjatur me shume se 30 minuta.Ne fund kroati ka lajmeruar lojtaret se pasditja do te jete e lire,e stervitja do te rifilloje neser ne oren 18:00 ne Durres